



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201700061/2

Tiranë ___/___/2017

Lënda: *Rekomandohet "Fillimi i hetimeve në ngarkim të shtetases A.K., me detyrë Drejtor në Shtëpinë e Fëmijës Parashkollor 3-6 vjec Shkodër, personi i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës", e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal".*

Drejtuar: Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor
Z. Granit SHAHU

SHKODËR

Për dijani: Prokurorit të Përgjithshëm
Z. Adriatik LLALLA

TIRANË

Të nderuar Zotërinj,

Në datën 21.12.2016, Komisioneri i Seksionit të Përgjithshëm dhe Nd/Komisionerët e Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, kryen monitorimin dhe inspektimin me objekt respektimin e të drejtave të fëmijëve të larguar nga Shtëpia e Fëmijës Parashkollor 3-6 vjec Shkodër, në kuadër të procesit të deinstitutionalizimit.

Metodologjia e përdorur për realizimin e këtij inspektimi konsistoi në kontrollin e gjithë dokumentacionit përkatës për çdo fëmijë, në zbatim të ligjit nr. 9062, datë 08.05.2003 "Kodi i famijles", ligji nr. 9355, datë 10.03.2005, "Pën ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, VKM-së nr. 659, datë 17.10.2005, "Për Standartet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, për Fëmijet në Institucionet Rezidenciale", si dhe Udhëzimit nr. 830, datë 14.04.2008, "Për zbatimin e Standardeve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale publike dhe jo-publike", të dalë në zbatim të kësaj VKM-je, VKM nr. 425, datë 27.06.2012 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jo publike të përkujdesit shoqëror", i ndryshuar, ligjit nr. 10347, datë 04.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve", si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij si dhe Udhëzimit 4 Ministror nr. 10, datë 25.02.2015, "Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes së fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve". Përveç

kontrollit të dokumentacionit në Shtëpinë e Fëmijës Parashkollor 3-6 vjec Shkodër, grupi inspektues kreu monitorimin e dokumentacionit në Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, pranë Bashkisë Shkodër e Njësisë Administrative Nr.7, dhe Nr. 11, Tiranë, si dhe vizitat në familjet ku janë kthyer fëmijët.

Aktualisht në këtë institucion ishin të akomoduar 4 fëmijë, me një staf administrativ që kujdesej për ta, prej 16 personash. Që nga inspektimi i fundit i kryer nga Nd/Komisionerët e Avokatit të Popullit i cili daton më 26.05.2016, nga ky institucion janë larguar 14 fëmijë. Konkretisht dokumentacioni i kontrolluar nga Nd/Komisionerët e Avokatit të Popullit, në prani të stafit dhe drejtueses së institucionit janë:

- Rregjistri themeltar i vendosjes dhe largimit të fëmijëve nga institucioni.
- Dosjet personale të fëmijëve të larguar nga institucioni
- Procesverbalet e dorëzimit të fëmijëve
- Shkresat zyrtare të ardhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror për transferimin e fëmijëve.
- Shkresat zyrtare të dërguara nga Shtëpia e Fëmijës Parashkollor 3-6 vjec Shkodër NMF-ve/Drejtoreve të Shërbimeve Sociale në Bashki për vlerësimin e situatës social-ekonomike të fëmijëve të larguar nga institucioni.

Nga verifikimi i rregjistrit themeltar i vendosjes dhe largimit të fëmijëve nga institucioni rezultoi se:

- 7 fëmijë janë kthyer në familjet biologjike,
- 6 fëmijë janë transferuar në institucione të tjera,
- 1 fëmijë është vendosur në shërbim kujdestarie.

Fëmijët e larguar nga institucioni, si rezultat i mbushjes së moshës, janë dorëzuar me deklaratë noteriale, të nënshkruar nga dorëzuesi dhe marrësi në dorëzim familjarëve. Nga verifikimi i këtyre deklaratave noteriale konstatoam se në rastin e fëmijës me inicialet Sh. G, ai është marrë në dorëzim nga gjyshja e tij, znj. File Gashi, e cila jetonte në lagjen Liria, në të dalë të qytetit të Shkodrës. Edhe pse fëmija është marrë nga gjyshja, ajo nuk ka një vendim gjykate i cili të vërtetojë kujdestarinë ligjore të saj kundrejt fëmijës me inicialet Sh.G, në shkelje të dispozitave të Kodit të Familjes së R.Sh. Këtë informacion e vërtetojmë me aktin noterial Nr. 1317 Rep. Nr. 856 Kol, datë 20.07.2016, të noteres Majlinda Dibra, kopje të të cilit do ta gjeni bashkëlidhur këtij rekomandimi.

Nga kontrolli i afateve kohore bërë rregjistrin themeltar të vendosjes dhe largimit të fëmijëve nga institucioni, rezultojnë që fëmijët e kthyer në familjet biologjike janë konkretisht 3 fëmijë mbi moshën 6 vjec, 3 fëmijë mbi moshën 7 vjec dhe 1 fëmijë mbi moshën 9 vjec. Në inspektimin e fundit të bërë në këtë institucion, në datën 26.05.2016, drejtoresha e këtij institucioni pretendoi se mbajtja e këtyre fëmijëve mbi moshën 6 vjec është bërë pasi shumica e tyre ishin motra dhe vëllezër dhe për këtë arsye ishte parë interesi më i lartë i fëmijës, ku në këtë institucion në zbatim të Projektit IACA do të ndryshohej tipologjia e shërbimit të institucionit, ku janë ndërtuar dhe dy shtëpi familje, në katin e dytë të këtij institucioni. Ky qëndrim i mbajtur nga ana e drejtoreshës në inspektimin e realizuar në datën 26.05.2016, nuk rezultoi të ishte i njëjtë me qëndrimin

e saj, në inspektimin e datës 21.12.2016, nga ku rezultoi se këta fëmijë ishin larguar nga ky institucion si rezultat i tejkalimit të moshes së qëndrimit në këtë qendër.

Nga kontrolli i 7 dosjeve të fëmijëve të kthyer në familjet biologjike, nuk rezultonte plani i largimit i të fëmijëve nga institucioni, në shkelje të VKM-së nr. 659, datë 17.10.2005, “Për Standartet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, për Fëmijet në Institucionet Rezidenciale”, si dhe Udhëzimit nr. 830, datë 14.04.2008, “Për zbatimin e Standardeve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale publike dhe jo-publike”, ku parashikohet se: 9 muaj para mbushjes së moshës së fëmijës për tu larguar nga institucioni, ekipi multidisiplinar i ngritur në zbatim të standartit nr. 2 të kësaj VKM-je, vlerëson nevojën e shërbimeve publike dhe jo publike për kthimin e fëmijës në familjet biologjike ose transferimin e fëmijës në institucion tjetër, në përputhje me planin e zhvillimit të fëmijës.

Gjithshtu në zbatim të neneve 263 dhe 267 të Kodit të Familjes së R. Sh, VKM nr. 425, datë 27.06.2012 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jo publike të përkujdesit shoqëror”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 6, datë 21.05.2014 “Për procedurat e sistemimit të fëmijëve në institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror publike dhe jo-publike”, fëmijët vendosen në institucion me Vendim Komisioni të Shërbimit Social Shtetëror, ose me vendim të Këshillit të Qarkut ose të Bashkisë, brenda 12 muajsh drejtuesi i institucionit duhet të paraqesë kërkesën për marrjen e kujdestarisë ligjore të fëmijës pranë gjykatës së vendbanimit ose vendqëndrimit të fëmijës. Grupi inspektues nga kontrolli i dokumentacionit në dosjen personale të fëmijëve të kthyer në familjet biologjike, pavarësisht periudhës kohore mbi 12 muaj të vendosjes së tyre në institucion, konstatoi se në dosjet e fëmijëve mungonin vendimet e gjykatës për marrjen e kujdestarisë ligjore së fëmijëve nga institucioni.

Nga verifikimi i dokumentacionit vihet re se shkresat e Shërbimit social Shtetëror, datojnë pas datës së inspektimit të fundit të bërë nga institucioni i Avokatit të Popullit, e më konkretisht shkresa nr. 1238/1, datë 30.05.2016, shkresa nr. 1650/1, datë 01.08.2016, shkresa nr. 1892/2, datë 02.09.2016, në të cilat kërkohet transferimi i 8 fëmijëve nga kjo shtëpi fëmije.

Nga kontrolli i dosjeve të fëmijëve të larguar në familje RVNE-të, ishin të paplotësuar sipas akteve nënligjore të sipërcituara VKM nr. 659, datë 17.10.2005, “dhe Udhëzimit nr. 830, datë 14.04.2008. Dosjet përmbanin vetëm dokumenta zyrtarë (vendime pranimi, certifikata, deklarata noteriale), po jo dokumenta që të vërtetojnë masat e marra për hartimin e planit të largimit. Dosjet e fëmijëve të transferuar në institucione të tjera, nuk ndodheshin në këtë institucion me pretendimin se së bashku me fëmijën është dërguar dhe dosja origjinale institucionit pritës.

Për këtë situatë të gjetur në këtë institucion u mbajt procesverbali midis palëve përfaqësuese të të dy institucioneve, kopje të të cilit do të gjeni bashkëlidhur.

Në zbatim të metodologjisë së sipërcituar, grupi inspektues realizoi monitorimin në Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve në Bashkinë Shkodër. Nga kontrolli I dokumentacionit rezultoi se Shtëpia e Fëmijës Parashkollor 3-6 vjec Shkodër, e ka njoftuar këtë NJMF,

pasi fëmija është kthyer në familjen e gjyshes për monitorimin e fëmijës. Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, Shkodër nuk është njoftuar paraprakisht nga ky institucion për të realizuar vlerësimin e situatës social-ekonomike të familjes së gjyshes duke patur parasysh interesin më të lartë të fëmijës.

NjMF-ja vlerësoi rastin në fjalë, të fëmijës me inicialet Sh. G ku konstatoi se kushtet familjare dhe ambientale, si dhe të ardhurat financiare nuk garantojnë mirërritje dhe edukim të fëmijës Sh. G, e vërtetuar me anë të shkresës zyrtare të Bashkisë Shkodër me nr. 10601 prot, datë 30.08.2016.

Nga ana e grupit inspektues u krye një vizitë monitoruese në ambientet ku jetonte fëmija, ku u vërtetua situata e përshkruar nga NJMF Shkodër. Bashkëlidhur fotografitë e ambienteve ku jetonte fëmija.

Nga ana jonë, u vazhdua me inspektimet e fëmijëve të tjerë të kthyer në familjet biologjike, e konkretisht të fëmijës R. D i cili ishte marrë nga kjo shtëpi fëmije nga i jati, me adresë banimi në Kamëz, Tiranë, person me precedent penal, i cili në datën e inspektimit të kryer nga ana jone, më 24.01.2017, rezultoi i ndaluar në institucionet e privimit të lirisë.

Fëmija me inicialet R. D është marrë në dorëzim nga prindi i tij biologjik, babai, më datë 03.06.2016 dhe është identifikuar nga punonjësit e policisë së Komisarariatit nr. 6, në situatë rruge në datën 11.09.2016. Nga hetimi i kryer nga grupi inspektues, në Njësinë Administrative Nr. 7 dhe Nr. 11, rezultoi se fëmija është identifikuar në situatë rruge në vitin 2015, nga ku është sistemuar në Shtëpinë e Fëmijës Parashkollor 3-6 vjec Shkodër me Urdhër Pranimi nr.1132/1, datë 15.05.2015 Komisionit të Shërbimit Social Shtetëror. Në datën 03.06.2016 fëmija me inicialet R.D i është dorëzuar prindit dhe në shtator 2016 ai është rigjendur përsëri në situatë rruge. Nga hetimi dhe dokumentacioni i mbledhur nga grupi inspektues në Njësinë Administrative Nr.11, rezultoi se: me shkresën zyrtare me nr. 4032 Prot, datë 16.09.2016, kjo Njësi i kërkon Shërbimit Social Shtetëror risistemimin e fëmijës me inicialet R. D, në institucionet e përkujdesit social rezidencial, në varësi të këtij institucioni. Në momentit e inspektimit NJMF-ja (Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve) nuk dispononte asnjë shkresë zyrtare në përgjigje të kërkesës për fëmijën i cili është sistemuar nga ky institucion në vitin 2015, në Shtëpinë e Fëmijës Parashkollor 3-6 vjec Shkodër, institucion nën varësinë administrative të Shërbimit Social Shtetëror, dhe kthehet në familjen biologjike në Qershor 2016 me mungesa të theksuara në dokumentacion, të sipërcituara dhe përfundon në Shtator 2016, në situatë rruge, ku Shërbimi Social Shtetëror është njoftuar me shkresë zyrtare për risistemimin e fëmijës për shkak të së njëjtës situatë të ndodhur dhe një vit më parë dhe nuk kthen asnjë përgjigje zyrtare për rastin në fjalë, në zbatim të legjislacionit të mbrojtjes sociale. Ky fëmijë është institucionalizuar me ndihmën e ARSIS, organizatë jo-fitimprurëse, në datën 14.09.2016, në Subjektin Jo-Publik “Vatra e ngrohtë”, Gjirokastër e cila ofron shërbime të përkujdesit social-rezidencial për fëmijët në nevojë.

KONKLUZIONE:

Nga analiza në tërësi e rastit, rezultoi se drejtori i Shtëpisë së Fëmijës Parashkollor 3-6 vjec Shkodër, me veprimet dhe mosveprimet e saj në ushtrimin e detyrës funksionale,

ka shkelur dispozitat ligjore dhe nënligjore që rregullojnë të drejtat e fëmijëve të sipërcituara në këtë rekomandim, si dhe parimet e Interesit më të lartë të fëmijës dhe atë të mirërritjes së fëmijës, të parashikuara në Konventën “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, më konkretisht:

- **Mos plotësimi i dokumentacionit të plotë të vlerësimit social-ekonomik të familjes biologjike për realizimin e kthimit të fëmijës në familje sipas dispozitave ligjore të sipërcituara, në interesin më të lartë të fëmijës.**
- **Mos marrjen e kujdestarisë ligjore për fëmijët e institucionalizuar sipas dispozitave ligjore të parashikuara në Kodin e Familjes së R. Sh.**
- **Mos plotësimin e dosjeve personale të fëmijëve (planin e largimit) sipas standarteve të miratuara me VKM nr. 659, datë 17.10.2005, “Për Standartet e Sherbimeve të Përkujdesit Shoqëror, për Fëmijët në Institucionet Rezidenciale”.**
- **Dorëzimin e fëmijës gjyshes, në kundërshtim të dispozitave ligjore të Kodit të Familjes, e cila nuk ka të drejtën prindërore ndaj fëmijës me vendim gjykatë.**

Moskryerja e detyrave funksionale të sipërcituara, si rrjedhojë kanë sjellë pasojat e shkeljes dhe mosrespektimit të të drejtave të fëmijëve të parashikuara në Kushtetutën e R. Sh, Konventën për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë të drejtat e fëmijëve.

Veprimet dhe mosveprimet e kryera nga drejtori i kësaj Shtëpie Fëmijësh kanë sjellë si pasojë deinstitutionalizimin e sforcuar me pasoja shumë të rënda deri në shfrytëzimin e fëmijëve në situatë rruge.

Me qëllim kryerjen e një hetimi të gjithanshëm do të sugjerohet që organi i Prokurorisë të kryejë dhe disa veprime hetimore të nevojshme si:

1. Kryerjen e hetimeve më të thelluara në Shtëpinë e Fëmijës Parashkollor 3-6 vjec Shkodër, mbi procesin e kthimit të fëmijëve në familjet biologjike.
2. Shtrirjen e hetimeve edhe në institucione të tjera shtetërore të përfshira në këtë proces.

Për sa sipër dhe bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21 gërma “ç” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit” me ndryshimet përkatëse ku thuhet: *“Avokati i Popullit, pas përfundimit të hetimit, i rekomandon Prokurorisë të fillojë hetimet në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një veprë penale, ose të rifillojë hetimet e pushuara ose të pezulluara”*,

REKOMANDOJMË

“Fillimin e hetimit në ngarkim të shtetas A.K., me detyre Drejtor në Shtëpinë e Fëmijës Parashkollor 3-6 vjec Shkodër, person i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”.

Mbi qëndrimin që do të mbani ndaj rekomandimit, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, lutemi të na vini në dijeni brenda afatit 30 ditor.

Bashkëlidhur ju dërgojmë dokumentet e mëposhtme:

1. Akti noterial Nr. 1317 Rep. Nr. 856 Kol, datë 20.07.2016, i noteres Majlinda Dibra,
2. Procesverbali i datës 21.12.2016, i mbajtur në Shtëpinë e Fëmijës Parashkollor 3-6 vjec Shkodër,
3. Fotografitë e ambienteve ku jeton fëmija me inicialet Sh. G
4. Shkresën e Bashkisë Shkodër dërguar Shtëpisë së Fëmijës Parashkollor 3-6 vjec Shkodër, me nr. 10601, datë 30.08.2016.
5. Dosjen personale të fëmijës R.D të identifikuar në situatë rruge në vitin 2015 dhe 2016.
6. Shkresa nr. 4032, datë 16.09.2016.
7. Procesverbal Shkodër 15.05.2015

Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI